

VENDIM

Nr. 1091, datë 28.12.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 212, DATË 11.3.2015, “PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR PËR MINISTRINË E FINANCIVE, PËR PAGESËN E SHËRBIMEVE JURIDIKE PËR PËRFAQËSIMIN DHE MBROJTJEN NË ÇËSHTJEN E ARBITRAZHIT NDËRKOMBËTAR ICC NO. 20447/MHM S2 ALBANIA SHPK DHE RPYSCAN SYSTEMS INC. KUNDËR REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 dhe 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shuma në pikën 1, të vendimit nr. 212, datë 11.3.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhet 645 000 (gjashtëqind e dyzet e pesë mijë) euro.
 2. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi i kontingjencës, miratuar për vitin 2015.
 3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama